



UNIVERSITETI I PRISHTINËS FAKULTETI I EDUKIMIT

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti i Edukimit, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +383 38 229 209 * Email: edukimi@uni-pr.edu * edukimi.uni-pr.edu

Abstrakt i zgjeruar

Titulli i Punimit:

**NDËRLIDHJA E MOTIVIMIT DHE VETËVLERËSIMIT NË SUKSESIN AKADEMIK
TEK FËMIJËT E CIKLIT TË MESËM TË ULËT**

Autori:

Lirije Lika

Mentori:

Prof. Ass. Dr. Naser Zabeli

Programi:

Këshillim Pedagogjik

Viti akademik: 12.5.2026

Hyrja

Suksesi akademik i nxënësve është një nga çështjet më të rëndësishme në fushën e edukimit, pasi ndikohet jo vetëm nga aftësitë njohëse, por edhe nga faktorë psikologjikë dhe socialë. Motivimi dhe vetëvlerësimi konsiderohen faktorë kyç që ndikojnë në angazhimin e nxënësve në procesin mësimor dhe në rezultatet e tyre shkollore. Motivimi lidhet me dëshirën dhe përkushtimin për të mësuar, ndërsa vetëvlerësimi me perceptimin që nxënësit kanë për aftësitë e tyre akademike.

Gjatë ciklit të mesëm të ulët, nxënësit kalojnë ndryshime të rëndësishme emocionale dhe sociale, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në mënyrën se si ata e përjetojnë shkollën dhe procesin e të nxënës. Mbështetja nga prindërit, mësuesit dhe bashkëmoshatarët ndikon në zhvillimin e motivimit dhe vetëbesimit të tyre, duke krijuar kushte më të favorshme për sukses akademik.

Ky hulumtim synon të analizojë ndikimin e motivimit dhe vetëvlerësimit në suksesin akademik të nxënësve të ciklit të mesëm të ulët në Kosovë, si dhe të shqyrtojë rolin e mbështetjes sociale në zhvillimin e këtyre faktorëve.

Metodologjia

Studimi është realizuar me qasje sasiore dhe dizajn përshkrues-korrelativ, me qëllim të shqyrtimit të marrëdhënieve ndërmjet motivimit, vetëvlerësimit dhe suksesit akademik. Mostra përfshiu 150 pjesëmarrës, prej të cilëve 50 nxënës të moshës 11–14 vjeç dhe 100 mësimdhënës të ciklit të mesëm të ulët. Përzgjedhja e pjesëmarrësve u bë përmes mostrës së qëllimshme.

Për mbledhjen e të dhënave u përdor pyetësi Academic Self-Description Questionnaire (ASDQ), i cili mat vetëvlerësimin dhe motivimin akademik të nxënësve. Gjithashtu, u përdorën pyetësorë për mësimdhënësit dhe regjistrat shkollorë për sigurimin e të dhënave mbi suksesin akademik të nxënësve.

Të dhënat u analizuan përmes programit SPSS duke përdorur analiza statistikore përshkruese, analiza korrelative dhe regresion linear, me qëllim të testimit të hipotezave dhe identifikimit të marrëdhënieve ndërmjet variablave të studimit.

Rezultatet kryesore

Rezultatet treguan se ekziston një lidhje pozitive dhe statistikisht domethënëse ndërmjet vetëvlerësimit dhe suksesit akademik të nxënësve. Nxënësit me vetëvlerësim më të lartë kishin tendencë të arrinin rezultate më të mira shkollore. Gjithashtu, motivimi i brendshëm u lidh pozitivisht me suksesin akademik dhe angazhimin në procesin mësimor.

Studimi tregoi gjithashtu se mbështetja sociale nga prindërit, mësimdhënësit dhe bashkëmoshatarët ndikon pozitivisht në zhvillimin e motivimit dhe vetëvlerësimit të nxënësve. Nxënësit që ndihen të mbështetur emocionalisht kanë më shumë gjasa të tregojnë vetëbesim dhe

përkushtim në mësim.

Analiza e regresionit linear tregoi se vetëvlerësimi është parashikuesi më i fortë i suksesit akademik, ndërsa motivimi dhe mbështetja sociale ndikojnë më shumë në mënyrë indirekte përmes forcimit të vetëbesimit dhe angazhimit të nxënësve.

Diskutimi

Gjetjet e studimit janë në përputhje me literaturën bashkëkohore, e cila thekson rëndësinë e vetëvlerësimit dhe motivimit në suksesin akademik. Nxënësit që besojnë në aftësitë e tyre tregojnë më shumë këmbëngulje, pjesëmarrje aktive dhe rezultate më të larta në shkollë.

Rezultatet tregojnë gjithashtu se motivimi i brendshëm luan rol të rëndësishëm në procesin e të nxënës, pasi nxënësit që mësojnë për shkak të interesit personal kanë angazhim më të madh në aktivitetet akademike. Megjithatë, ndikimi i motivimit bëhet më efektiv kur shoqërohet me vetëvlerësim pozitiv.

Një rol të rëndësishëm luan edhe mbështetja sociale. Marrëdhëniet pozitive me prindërit, mësuesit dhe bashkëmoshatarët ndihmojnë në zhvillimin emocional të nxënësve dhe krijojnë një mjedis më të favorshëm për arritje akademike.

Përfundimet dhe rekomandimet

Studimi arrin në përfundimin se vetëvlerësimi dhe motivimi janë faktorë të rëndësishëm që ndikojnë në suksesin akademik të nxënësve të ciklit të mesëm të ulët. Vetëvlerësimi rezultoi të jetë faktori më i fuqishëm në parashikimin e rezultateve akademike, ndërsa motivimi dhe mbështetja sociale ndikojnë në mënyrë plotësuese.

Rezultatet theksojnë rëndësinë e krijimit të një mjedisi mbështetës në shkollë dhe familje, ku nxënësit të ndihen të vlerësuar dhe të motivuar për të mësuar. Mësuesit duhet të përdorin metoda motivuese dhe të ofrojnë mbështetje emocionale për nxënësit.

Rekomandohet që institucionet arsimore të zhvillojnë programe që promovojnë vetëvlerësimin, motivimin dhe mirëqenien emocionale të nxënësve. Gjithashtu, studimet e ardhshme mund të përfshijnë mostra më të mëdha dhe analiza më të thelluara mbi faktorët që ndikojnë në suksesin akademik në Kosovë.

Fjalë kyçe (3–5)

motivim, ndërlidhje, nxënës, sukses akademik, vetëvlerësi.

Extended abstract

Title of the thesis:

The Relationship Between Motivation, Self-Esteem, and Academic Success Among Lower Secondary School Students

Author:

Lirije Lika

Supervisor:

Prof. Assoc. Dr. Naser Zabeli

Study programme:

Master Studies – Pedagogical Counseling

Academic year:

2025/2026

Introduction

Academic success is considered one of the most important issues in the field of education, as it is influenced not only by cognitive abilities but also by psychological and social factors. Motivation and self-esteem are considered key factors that affect students' engagement in the learning process and their academic achievements. Motivation is related to the desire and commitment to learn, while self-esteem refers to the way students perceive their academic abilities and personal value.

During lower secondary education, students experience important emotional and social changes that directly affect the way they experience school and learning. Support from parents, teachers, and peers influences the development of their motivation and self-confidence, creating more favorable conditions for academic success.

This research aims to analyze the impact of motivation and self-esteem on the academic success of lower secondary school students in Kosovo, as well as to examine the role of social support in the development of these factors.

Methodology

This study was conducted using a quantitative approach and a descriptive-correlational design in order to examine the relationships between motivation, self-esteem, and academic success. The sample included 150 participants, of whom 50 were students aged 11–14 and 100 were lower secondary school teachers. The participants were selected through purposive sampling.

For data collection, the Academic Self-Description Questionnaire (ASDQ) was used to measure students' academic self-esteem and motivation. In addition, questionnaires for teachers and school records were used to obtain data regarding students' academic achievement.

The collected data were analyzed using the SPSS program through descriptive statistics, correlation analysis, and linear regression in order to test the research hypotheses and identify relationships among the study variables.

Main Results

The results showed a positive and statistically significant relationship between self-esteem and students' academic success. Students with higher self-esteem tended to achieve better academic results. Furthermore, intrinsic motivation was positively related to academic achievement and engagement in the learning process.

The study also showed that social support from parents, teachers, and peers positively affects the development of students' motivation and self-esteem. Students who feel emotionally supported are more likely to demonstrate self-confidence and commitment to learning.

Linear regression analysis revealed that self-esteem was the strongest predictor of academic success, while motivation and social support had a more indirect effect through strengthening students' confidence and engagement.

Discussion

The findings of the study are consistent with contemporary literature, which emphasizes the

importance of self-esteem and motivation in academic success. Students who believe in their abilities show greater persistence, active participation, and higher academic achievement.

The results also indicate that intrinsic motivation plays an important role in the learning process, as students who learn due to personal interest demonstrate greater engagement in academic activities. However, the impact of motivation becomes more effective when combined with positive self-esteem.

Social support also plays an important role. Positive relationships with parents, teachers, and peers contribute to students' emotional development and create a more supportive environment for academic achievement.

Conclusions and Recommendations

The study concludes that self-esteem and motivation are important factors influencing the academic success of lower secondary school students. Self-esteem was identified as the strongest predictor of academic achievement, while motivation and social support had complementary effects.

The findings highlight the importance of creating a supportive environment at school and within the family, where students feel valued and motivated to learn. Teachers should use motivating teaching methods and provide emotional support to students.

It is recommended that educational institutions develop programs that promote students' self-esteem, motivation, and emotional well-being. Future studies may include larger samples and more detailed analyses of the factors influencing academic success in Kosovo

Keywords:

motivation, interrelationship, students, academic achievement, self-esteem